

RIKTHIMI I LUAN TOPÇIUT

Nga Flora Nikolla

Luan Topçiu, një personalitet në botën akademike, i cili prej vitesh mban titullin Doktor Profesor, është rikthyer natyrshëm në qytetin e tij te lindjes...!

Ka ditë që ndodhet këtu buzë liqerit pa kufir të Lasgushit dhe Mitrushit, dy personalitete të kulturës sonë kombëtare ...që si dhe ai kanë studiuar dhe punuar në Bukuresht...!

Është një rikthimi i natyrshëm dhe i plotë i gjithi ky në qytetin ku natyra dhe njeriu jetojnë në paqe dhe harmoni ..., pavarësisht se ditë pas dite, vit pas viti qyteti i lules së dliirë dhe koranit hirëplotë, qyteti i mikpritjes dhe liqerit pa kufir, ndihet i atrofizuar...!!!

Duket sikur i tëri ky është një mision për njeriun që deri dje përfaqësonte Shqipërinë në Bukuresht të Rumanisë, ku dhe ka marrë titullin Doktor Profesor ...!!! (faqe 2)



TE VAZHDOJME SE BASHKU
për Velcanin

VOTO
ILIA MANI
 NR. 1

INTERVISTË ME KRYETARIN E KOMUNËS VELÇAN DHE KANDIDATIN Z. ILIA MANI



LSI ÇEL FUSHATËN ELEKTORALE NË KOMUNEN E BUÇIMASIT

BOTOHET KORESPONDENCA E LASGUSHIT DHE MITRUSHIT

"SHAKAJA"
 Tregim nga Istref HAXHILLARI

"DRAMA SHQIPE, DASHURIA IME E PARË DHE E VETME"



Flet regjisori veteran Tomi Mato në 85- vjetorin e lindjes

Fuat Fero: Do t'i kthej dinjitetin që meriton komunës së Proptishtit
Fjalë malli për vendlindjen

Nga Fahri BUFI

RIKTHIMI I LUAN TOPÇIUT

Nga Flora Nikolla

Luan Topçiu, një personalitet në botën akademike, i cili prej vitesh mban titullin Doktor Profesor, është rikthyer natyrshëm në qytetin e tij të lindjes...

Ka ditë që ndodhet këtu buzë liqerit pa kufir të Lasgushit dhe Mitrushit, dy personalitete të kulturës sonë kombëtare ...që si dhe ai kanë studiuar dhe punuar në Bukuresht...

Është një rikthimi i natyrshëm dhe i plotë i gjithi ky në qytetin ku natyra dhe njeriu jetojnë në paqe dhe harmoni ..., pavarësisht se ditë pas dite, vit pas viti qyteti i lules së dliërë dhe koranit hirëplotë, qyteti i mikpritjes dhe liqerit pa kufir, ndihet i atrofizuar...!!!

Duket sikur i tëri ky është një mision për njeriun që deri dje përfaqësonte Shqipërinë në Bukuresht të Rumanisë, ku dhe ka marrë titullin Doktor Profesor ...!!!

Qetazi ... si t'i rikthehej dhe të jetonte një kohë të shkuar sa edhe të afërt, duke rrëfyer lidhjen që ka me qytetin e tij, ai kujtoi Frojden me shprehjen e tij të njohur se "fëmijëria është babai i vërtetë i njeriut..."

... Misioni i tij si qytetar dhe intelektual e bën fisnik në rrugën e vështirë dhe të gjatë që ka përpara për qytetin e tij, që ai e cilëson të shpërfytyruar, të denaturuar dhe të betonizuar me masakrën që i është bërë dhe po i bëhet liqenit ...

"Qyteti mendtor dhe qyteti real nuk përkojnë fatkeqësisht dhe gjithmonë bëjnë që shumë qytetarë që marrin baltën e qytetit në këpucë e të mos shkëputen dot prej tij", thotë Luan Topçiu në këtë intervistë në një ditë me krivec liqeni dhe kur ethet e fushatës elektorale kishin pushtuar Pogradecin veshur me histori, qytet "palcërisht shqiptar", i futur në gjirin e maleve si truri në kafkën e njeriut.

Më shumë se modest dhe pa dashur jetë në rolin e një kritizeri, Luan Topçiu pohon në këtë intervistë se ajo që ofron "është që qyteti të bëhet qytet". "Pogradeci e ka të kufizuar bregun e liqenit ... dhe në këtë pak vend, në vend që të bëhen resorte turistike, hotele ..., të hapeshin vende pune dhe të kishte një turizëm cilësor, ai është masakruar në një formë të frikshme", thotë Luan Topçiu.

"Bashkia nga një bunker i mbyllur do të hapet për qytetarët, të bëhet transparent ku shkojnë paratë publike. Është në projektin tim që të bëhet një senat i qytetit, me burrat e mençur të qytetit... thotë ai në këtë intervistë ...

Teksa mbarojmë këtë intervistë e ecim buzë liqerit pa kufir një e moshuar, ndërsa e rrok ne qafë, i thotë mirësenardhe bir !!!

FN : Zoti Luan, ju vini



Meta: Pogradeci ka nevojë për një qytetar të parë, që e sheh veten jo si pronar por si shërbëtor të tij!

"Projekti i Aleancës për Qytetarin" për Pogradecin dhe gjithë Shqipërinë, ka në qendër qytetarin dhe integrimin e Shqipërisë në Evropë", tha kryetari i LSI, Ilir Meta, në takimin që organizoi kjo Parti, ditën e shtunë, në qytetin e Pogradecit, me rastin e çeljes së fushatës elektorale. Kryetari i LSI, Meta, shprehu bindjen se më 8 maj, Pogradeci, do të votojë kandidatin e LSI-së për kryetar bashkie, Luan Topçiu, një intelektual i shquar i këtij qyteti dhe projektin e përbashkët të grupimit politik "Aleanca për Qytetarin".

"Projekti i kandidatit, Luan Topçiu, ka në radhë të parë mbrojtjen e Pogradecit dhe liqenit të Ohrit që është një nga perlat e Shqipërisë dhe Ballkanit, mbrojtjen e vlerave kulturore e muzeale të qytetit duke e zhvilluar njëkohësisht qytetin, por pa e betonizuar atë, sikurse ka ndodhur me projektin e betonizimit të Ramës dhe Shkëmbit, i cili do të dështojë edhe në Pogradec në 8 maj", tha kryetari i LSI, Ilir Meta.

Në fjalën e tij, Ilir Meta nënvizoi se "Aleanca për Qytetarin" do të ketë përparësi të punës së saj ndërtimin e infrastrukturës rrugore të Pogradecit dhe kthimin e tij në një qytet metropol të turizmit në vend sepse, sipas tij, "Pogradecin



e ka bekuar Perëndia me bukuritë e natyrës që ka". Pjesëmarrësi i përshëndeti edhe kandidati për kryetar bashkie i "Aleancës për Qytetarin" Luan Topçiu, i cili parashtrori programin e tij elektorale dhe projektin për ndryshimin e qytetit të Pogradecit, ku përparësi kishin projektet për ndryshimin e infrastrukturës, për pastrimin nga mbetjet urbane, për ruajtjen e traditave dhe zhvillimin e arsimit, kulturës dhe sportit, me qëllim që Pogradeci të zërë vendin e tij të merituar dhe të konkurojë me dinjitet në zhvillimin e turizmit.

nga bota akademike dhe nga bota e diplomacisë për të kandiduar si kryetar bashkie në qytetin tuaj të lindjes...

L.T : Pogradeci nuk është qyteti ku unë kthehem, Pogradeci është qyteti ku unë kam jetuar në çdo rrethanë. Edhe gjeografikisht kur jetoja larg tij, jeta ime ishte e lidhur pazgjidhshmërisht me të, me jetën e tij, me ndodhitë, zhvillimin e tij, me jetën e njerëzve të tij ...Jeta ime është e lidhur me këtë qytet sepse siç thotë Frojdi, "fëmijëria është babai i vërtetë i njeriut". Pogradeci është vendi ku kam lindur, ku kam parë qiellin për herë të parë, ku kam përjetuar gëzimet e para të fëmijërisë, me njerëzit e mi të dashur. Jam larguar i vogël, me një valixhe druri për të studiuar në Liceun Artistik në Tiranë, pastaj kam studiuar Letërsi e më pas kam punuar në Pogradec. Pastaj jam larguar për të studiuar në Rumani, në Bukuresht, për shtatë vite në letërsi të krahasuar dhe ku mbrojta doktoraturën në vitin 2000. Më pas, kam kryer edhe një master për të drejtë ndërkombëtare dhe administrim në Bukuresht, ku kam punuar vitet e fundit diplomat pranë ambasadës sonë në Bukuresht. Lidhjet e mia me qytetin nuk kanë qenë të shkëputura. Çdo verë, në çdo mundësi që më jepej, në çdo festë ka qënë Pogradeci dhe kam kërkuar që të jem këtu. Rrënjët e familjes, njerëzit e mi të afërt, janë të gjithë këtu, kujtimet e mia janë këtu, kështu që asnjëherë nuk jam ndjerë i tjetërsuar nga ai.

FN : Duke ju dëgjuar për çka treguat, më kujtoni se shumë njerëz të mëdhenj të këtij qyteti kanë ikur dhe i janë rikthyer këtij qyteti sikundër dhe ju. Çfarë keni ndjerë ju në rikthimet tuaj fizike kur keni parë qytetin në këto vite ?

L. T : Qyteti mendtor dhe qyteti real nuk përkojnë fatkeqësisht dhe gjithmonë bëjnë që shumë qytetarë që marrin baltën e qytetit në këpucë e të mos shkëputen dot prej tij. Por, ka qënë qyteti i tyre i pazëvendësueshëm që janë kthyer deri në ndarjen e tyre nga jeta. Këto 20 vitet e fundit ne kemi pasur ëndrra të mëdha për qytetin, ne kemi dashur që ky qytet të ndryshojë. Kujtoj, periudhën mes dy Luftërave Botërore kur Pogradeci ishte një qytezë e vogël, por me tentativë për t'u bërë një qytet me tipare europiane edhe falë inxhinierit Garik, që jetoj në këtë qytet dhe planeve të tij urbanistike. Atëherë qyteti kishte një kinema, u projektua një treg, vilat që u ndërtuan kishin ajër perëndimor dhe qyteti ishte i mbytur në gjelbërim. Natyra dhe njeriu jetonin në paqe dhe në një harmoni për ta patur zili.

Ndërhyrjet e periudhës së komunizmit me ndërtimet standarde e dëmtuan qytetin.

(vijon në faqen 4)

INTERVISTË ME KRYETARIN E KOMUNËS VELÇAN DHE KANDIDATIN E PAVARUR Z. ILIA MANI

Le të vazhdojmë së bashku!

Ilia Mani, kryetari aktual i komunës së Velçanit, Ilia Mani, është kandidat i pavarur për zgjedhjet e 8 majit. Ilia bënte pjesë në LSI, por kur ajo forcë politike u bashkua me të djathtën, ai ishte dhe mbeti i majtë, duke vijuar kontributin e tij në dobi të bashkëfshatarëve të tij. Ilia Mani, duke qenë se kishte një kontratë ligjore dhe morale me bashkëfshatarët e tij, një mision për të çuar deri në fund, një sipërmarrje të suksesshme për të mbaruar, doli si kandidat i pavarur për të sfiduar dy partitë e mëdha, PD dhe PS, të cilat, për hir të së vërtetës, nuk kanë ndonjë përfaqësim konkurrues e për më tepër janë me shumë disavantazhe për të qenë nesër ata drejtues të komunës. Ilia Mani është kryetari që u zgjodh katër vjet më parë me votat e të gjitha forcave politike dhe shpreson dhe është i bindur se do të fitojë edhe kësaj here, sepse më shumë se në mandatin e parë, ai ka fituar besimin, banorët e dinë dhe e njohin besën dhe përkushtimin e tij për drejtimin e komunës. Në poshtë z. Ilia shpalos strategjinë dhe optimizmin e tij për mandatin e dytë. Jemi në vitin 2011 dhe zgjedhësit nuk ecin më vetëm sipas bindjeve politike, (nuk është koha që edhe sikur një hu të vesh zgjedhësit e votojnë) tashmë ata dinë të bëjnë diferencën, dinë të zgjedhin dhe zgjedhja më e mirë për zgjedhjet e 8 majit është Ilia Mani, sepse motoja e tij është e thjeshtë: "Besimi juaj, përgjegjësia ime", "Halli juaj, zgjidhja ime". Banorë të Velçanit, Ilia Mani është i pari, e vetmja mundësi, është shpresa juaj për të ardhmen!

- *Z. Ilia, në këto zgjedhje ju kandidoni si i pavarur. Jemi drejt fundit të fushatës si e shikoni ju veten në finishin e 8 majit?*

- Për mua fushata nuk ka nisur tani. Unë kam më shumë se katër vjet që takoj banorët e mi, kam shkelur çdo fshat, çdo lagje, çdo shtëpi e pse jo çdo banor të kësaj komune. Unë jetoj me ta, i di hallet dhe problemet, u di nevojat por u kam gjetur edhe zgjidhjet, edhe shpresën. Unë jam kryetari që jetoj mes tyre. As e kam drejtuar e as e drejtoj komunën me celular. Unë nuk e braktisa vendin tim, jo se nuk kam pasur mundësi, por sepse e ardhmja ime është këtu. Në zgjedhjet e 8 majit shpresoj dhe besoj se do të jem unë fituesi.



1. Rikonstrukcioni i ujësjellsave për fshatrat Bishnicë – Velçan dhe ndërtimi i linjës së re Laktesh

2. Kalimi dhe sistemimi i rrugës kryesore Proptisht- Losnik- Velçan, Laktesh – Velçan – Buzaishtë- Bishincë

3. Vazhdim i rikonstrukcionit të shkollave në Bishnicë, Buzaishtë, Senisht

4. Vazhdim i projektit të përmirësimit të pyllit (mbjellje, ricungim, rrallim pastrim).

- *Kaluan katër vjet dhe kur bëni bilancin e punës dhe drejtimit tuaj, çfarë keni bërë konkretisht për komunën?*

- Në katër vite janë bërë shumë gjëra, kanë ndryshuar dhe do të ndryshojnë edhe në të ardhmen. Unë do të rendisja si suksese të punës sime dhe stafit tim këto:

- Përfundoi rikonstrukcionin i shkollave Velçan, në vlerën 30 milionë lekë dhe Laktesh në vlerën 70 milionë, me mbështetjen e ambasadës gjermane.

- U ndërtua linja e rrejtës kryesor si dhe puceta e ujit e fshatit Buzaishtë. Po ashtu Lagjia Elezi u ndërtua një pucetë uji.

- U ndërtuan rrugë të brendshme në lagjet e Bibave, Lufave, në Velçan, Kodër Çelë, lagja e Velos e Çelës në Buzaishtë.

- Janë në përfundim të tjera rrugë si ajo e Lufave në Buishnicë, e Hykos në Buzaishtë, e Shesheve në Laktsh, Kroji i Madh Velçan, Lagjia e Dervishëve në Losnik, etj.

- Organizuar për herë të

arë fesëtnë e komunës dhe shpërsojmë ta kthejmë në traditë, çdo 20 gusht.

Në bashkëpunim me shoqatat CHV, NEHEMIA, organizuam projektin "Adidas" me nxënësit e shkollave të komunës sonë.

Po ashtu i rëndësishëm ishte edhe projekti për gruan, po me këto shoqata. Ka nisur puna edhe për rikonstrukcionin e shkollës së Bishnicës me një fond prej 25 milion lekësh.

Realizuar projektin e Pyllit me shoqatën holandeze SNV në vlerën 110 milionë lekë, ku komuna jonë është zgjedhur në projektin pilot. Kemi bërë edhe shumë të tjera, por mbi të gjitha ne u jemi gjendur pranë çdo familjeje, e banor në problemet që kanë pasur. Dera e komunës ka qenë gjithmonë e hapur dhe të rrallë kanë qenë ata, për të mos thënë askush, që kanë dalë prej derës së pakënaqur.

- *Si i shikoni dy kandidaturat e tjera nga PD dhe PS?*

- Unë nuk do të bëja asnjë lloj vlerësimi për kandidatët e tjetër, pasi vetë populli i njeh dhe do t'i japë secilit atë që meriton. Unë, siç thashë jetoj në Velçan, ndërsa dy të tjerët jo, ata kanë ardhur për të na "shpëtuar", kur vetë ikën për të shpëtuar prej Velçanit! Nuk drejtohet komuna duke banuar në Pogradec! Ata erdhën se i ngarkoi Partia jo se i thirri toka, vendlindja apo populli.

- *Cilat janë disa nga premtimet tuaja për mandatin e ri?*

- Unë nuk bëj premtime, unë shpalos projekte të cilat janë vënë në vijë dhe do të realizohen në mandatin e dytë. Nuk premtoj asfalt në Velçan, por rrugë.

- Kështu, do të bëj rikonstrukcionin e ujësjellsave për fshatrat Bishnicë, Velçan dhe ndërtimi i linjës së re të ujësjellsit në Laktesh

- Kalimi dhe sistemimi i rrugës kryesore Proptisht- Losnik- Velçan – Laktesh – Velçan – Buzaishtë- Bishincë

- Sistemimi i rrugës Senisht-Stravaj

- Vazhdimi i projektit të pastrimit të plehrave edhe në fshatrat e tjera

- thurja e te gjithave varrezave të fshatave

- Vazhdim i rikonstrukcionit të shkollave në Bishnicë, Buzaishtë, Senisht

- Vazhdim i projektit të përmirësimit të pyllit (mbjellje, ricungim, rrallim pastrim).

Pa harruar e lënë mënjane punët e përditshme që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me hallet e banorëve. Unë jam aty, mes jush, gjithmonë me derën hapur për problemet tuaja!

- *Cili është mesazhi juaj për zgjedhësit?*

Zgjedhës është radha juaj! Mos shikoni partitë, por shikoni njeriun, atë që ju bën punë, jo premtime! Kini besim sepse besimi juaj, përgjegjësia ime, halli juaj, zgjidhja ime. Le të vazhdojmë së bashku edhe katër vjet!

- **Ju Faleminderit dhe suksese!**

(vijon nga faqja 2)

Por, ne prisnim shumë që pas viteve '90 të ndodhte diçka. Qyteti që ne gjëmë është i shpërfytyruar, i denaturuar, është një qytet i betonizuar vitet e fundit, ku ka ndërtime pa kriter dhe ndërtime pa leje, shtesa katesh ... Është një masakër që është bërë me liqenin dhe ajo që është më e rënda është dora që i është vënë gjelbërimit dhe bregut të liqenit. Për herë të parë po shikojmë ndërtime me beton, dhjetra pallate që ndërtohen në një formë galopante të frikshme në bregun e liqenit, pa respektuar planet e miratuara nga qeveria e Fatos Nanos në 2003. Kjo do të jetë një nga dramet e pariparueshme që po i ndodh qytetit sot. Mendoj që duhet t'i themi stop të keqes. (Vijon)

F. N: Ju jeni takuar me banorët e qytetit gjatë këtyre ditëve. Si e kanë përjetuar ose si e përjetojnë banorët autoktonë këtë metamorfozë që ka pësuar Pogradeci?

L. T: Përshtypja ime nga kontakti dhe dialogu im i përhershëm është se janë të një mendje me mua që qyteti është në prag të një krimi të rëndë urbanistik. Por ka dhe probleme të rënda papunësie, probleme ekonomike. Çështja është që Pogradeci është një qytet turistik dhe bregu i liqenit është i pakthyeshem. Pogradeci e ka të kufizuar bregun e liqenit ... nga hyrja e tij deri tek Vilat, siç e quajne banorët. Dhe në këtë pak vend, në vend që të bëhen resorte turistike, hotele ..., të hapeshin mundësi punësimi dhe një turizëm cilësor, siç e meriton një vend me peizazhet më të bukura që mund të prodhojë mendja njerëzore, ai është masakruar në një formë të frikshme. Është një përgjegjësi shumë e madhe e atyre që kanë marrë nisma të tilla. Me sa duket korrupsioni dhe etja për pasuri e një klientele të vogël njerëzish ka bërë që të mos shikojnë se ç'po i bëjnë qytetit me këtë verbëri që dëmton në mënyrë të pariparueshme qytetin tonë të dashur që ka nevojë të bëjë një SOS.

F. N: Çfarë ofroni ju konkretisht në platformën tuaj si kandidat dhe më vonë si kryetar i bashkisë së Pogradecit?

L. T: Sigurisht nuk do më pëlqente fare të bëja kritikun, as kritizimin në këto zgjedhje, sepse është gjëja më e thjeshtë të kritikosh dhe sigurisht nuk u them asgjë të re qytetarëve të mi nëse kritikoj dhe konstatoj ato që ndodhin. D.m.th pallate mbi parqe, ndërtime pa kriter, bulevardet të ngushtuara, të zvogëluara, me një shije mediokre, të gjitha janë vetëm konstatime. Ajo që ofroj unë është që qytetin ta bëjmë qytet, sepse ai duke e trajtuar në këtë mënyrë bëhet një proces ruralizimi, kthehet në qendër fshati. Qyteti është zmadhuar 3-4 herë në mënyrë sasiore dhe duhet rikonceptuar, rimenduar që të kthehet në qytet.

Qyteti që ka pasur kinema, nuk ka më kinema, nuk ka muze, nuk ka jetë artistike, ka probleme të rënda sociale, me papunësi, varfëri, që kërkojnë zgjidhje imediate. Ofroj punësim me ekipin tim dhe mendojmë të krijojmë një plan punësimi me reforma të rëndësishme me ndihmën e qeverisë shqiptare.

Kursë nga pikpamja urbanistike, synoj një plan urbanistik që të respek-



tohet në formën më strikte. Bashkia nga një bunker i mbyllur, duhet të hapet për qytetarët, të bëhet transparencë ku shikojnë paratë publike. Është në projektin tim që të bëhet një senat i qytetit me burrat e mençur të qytetit.

Përveç këshillave bashkiake, që janë politike, do të krijohet dhe një këshill permanent me artistët, intelektualët, njerëz që e duan qytetin dhe dua të bëhet një oponentë të fortë për çdo vendimarrje, çdo vendim që merret nga bashkia të merret në konsultim me ta, një vendim konsensual që është i domosdoshëm për të marrë vendimet më të mira të qytetit. Qyteti, sipas projektit tim, dhe kjo është kryefjala e fushatës, është që ai të kthehet në një qendër rajonale. Ne do të konkurrojmë pa frikë me Ohrin me Strugën në Maqedoni dhe me Korçën, qytet shumë pranë nesh. Popullsia do të shkojë në 70 000 banorë dhe ne do marrim masat që si qendër urbane të përballojë kërkesat në rritje të popullsisë. Pogradeci duhet të ketë një qendër universitare dhe një qendër turistike. Duhet të riaktivizohen disa pika, siç është Kalaja, të ndërtohen disa pika të vizitueshme në qytet, sepse turizëm nuk do të thotë vetëm gastronomi, por edhe të lëvizet dhe turistët të njihen me vlerat historike që ka një qytet. Kemi artistë shumë të mirë, galeria, mund të kthehet në një qytet pelegrinazhi për shkak të shkrimtarëve të mëdhenj që ka ky qytet, vargjet e tyre mund të shkruhen kudo, të bëhen festivale poetike të rangjeve kombëtarë dhe ndërkombëtare. Të gjitha lidhjet e mia që kam me botën diplomatike e artistike do të bëhen efçente, që Pogradeci të jetë një vend ku të bëhen festivale për fëmijë, për të rritur, të hapen ekspozita ndërkombëtare, ballkanike.

F. N: Mendoni se pogradecarët si njerëz të mençur, mikëpritës dhe si njerëz të traditës, do ta kuptojnë vërtet këtë herë që nuk janë bindjet politike ato që përcaktojnë atë që duhet të jetë kryetar bashkie, por të votojnë individin, sikundër jeni ju, një personalitet me një platformë shumë të qartë në të gjitha aspektet, të prezantuar për këtë fushatë.

L. T: Mendoj se është një moment emancipimi dhe mendoj se do bëhet zgjedhja më e mirë për qytetin. Është e rëndësishme që njerëzit të kuptojnë që

unë jam kthyer në qytet. Kam dashur të bëj libra dhe i kam bërë, kam dashur të bëj profesor dhe profesor jam bërë, kam dashur të bëhem diplomat dhe diplomat jam bërë, të gjitha lidhjet, njohuritë, potencialet e mia do t'i vë në shërbim të qytetit.

F.N: Uroj sepse Mitrusi i madh, Lasgushi i madh, kanë studiuar në

Rumani, janë rikthyer në qytet pa arritur të bëjnë atë që dëshironi ju të bëni...

L.T: Sigurisht është një ndjenjë krenarie që kthehem nga ato vise ku ata kanë studiuar. Kam jetuar gjatë aty ku kanë jetuar edhe dy nga kolosët e qytetit tim, por dhe simbole të kulturës kombëtare. Kam kaluar në universitetet ku kanë kaluar ata, kam dhënë mësim aty ku kanë kaluar ata dhe jam munduar t'i nderoj aty ku kam qënë. Kam organizuar aktivitete speciale për ta, i kam përkthyer në rumanisht, i kam bërë të njohur në vendet ku kam qënë, qoftë në televizione kombëtare rumune qoftë në ambiente akademike, qoftë në Lidhjen e Shkrimtarëve të Rumanisë. Kam përkthyer novelat e Kutelit, kam përkthyer poezitë e Lasgushit dhe kam bërë aktivitete shumë të rëndësishme në atë vend për t'i bërë të njohur ata. Sigurisht kjo është një pjesë emocionale e historisë sime që lidhet me qytetin dhe me këta personalitete të rëndësishme të kulturës kombëtare. Unë mendoj që qytetet kanë shpirtin e tyre dhe siç ka shpirt njeriu ka dhe vendi shpirt dhe qyteti duhet të duhet siç duhen njerëzit. Dhe ofroj dashurinë time, njohuritë e mia për t'i vënë në shërbim të qytetit.

F.N : Suksese dhe faleminderit.

FLET KANDIDATI I PS PËR KOMUNËN E PROPTISHTIT:

Fuat Fero: "Do t'i kthej dinjitetin që meriton komunës"

Pas një hezitim disa vjeçar PS ka gjetur më në fund një kandidat që premtion dhe ka më shumë shanse t'i kthejë pushtetin kësaj force të majtë. Ai është mësuesi nga Slabinja Fuat Fero. Të gjithë e njohin Fuatin dhe nuk ka nevojë për prezantim, pasi jeton mes tyre dhe ka mbi 20 vjet që ka nxjerrë sa e sa breza nxënësish. Nga dijet e tij janë formuar e po formohen me dhjetëra të rinj jo vetëm në Slabinjë, por më gjerë. I angazhuar në PS-në e rrethit dhe atë lokale, Fuati pranoi kandidaturën, si një person i përshtatshëm dhe që ka shanse vërtet për t'u përballur me kandidatin e djathtë, Shaban Sula, i cili, pas dy mandatesh, lufton për të tretin. Në një bashkëbisedim të shkurtër Fuati flet thjesht, e pak, ose si i thonë ndryshe, pak e sak".

"Jeni njohur me problemet që ka komuna Proptisht, një situatë që e kam njohur edhe më parë të cilët kam vite që e jetoj. Unë premtoj, por u siguroj atyre një qeverisje më të mirë. Unë ofroj zgjidhje. Unë si individ, por edhe si kandidat e ndiej si obligim të çoj dinjitetin e njerëzve në vend. Komuna ka nevojë për njerëz të aftë dhe unë dua të ndërroj gjithë kuadrin e komunës, të vendos njerëz të aftë, edhe po të jenë të krahut të kundërt politik. Nëse do të bëhem kryetar komune, pjesë të kuadrin do të bëj një jurist/e që të njohë mirë ligjet, t'i vejë në zbatim dhe të ndryshojë situatën. Komuna dhe komuniteti ka nevojë për shërbëtorë dhe jo për pronarë. Ka vite që është premtuar por nuk është bërë



asgjë dhe unë do të lidhja kryesitë e fshatrave me komunën. Sot, pushë në sytë e njerëzve një zhgënjim shumë të madh dhe duke menduar një gjë të tillë nuk mundem t'i gënjej me fjalë boshe. Thjesht më duhet mbështetja e këtyre banorëve për të ecur përpara dhe për t'i zgjidhur sëbashku problemet nga ato më të mëdha e nga më shqetësueset e deri tek problemet e vogla me të cilat përballemi çdo ditë. Është parë se çfarë është bërë deri tani dhe unë si banor i kësaj komune i di mjaft mirë problemet, por kam pyetur edhe popullin gjithashtu. E di se çfarë duhet të bëj dhe ato që na shqetësojnë janë problemet e të gjithëve ne. Një gjë u premtoj të gjithë banorëve se nëse zgjidhem kryetar, dera e zyrës sime do të jetë gjithmonë e hapur për ju dhe zyra ime është në komunë, jo në klub!

Bora SHAHINI

Kryeredaktor; Flori SLATINA

Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI, Zabit ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE, Llazi TONA

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"
Istref Haxhillari, Zabit Çuku, nënkryetarë të shoqatës
Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

www.pogradeci.com/mokra

Vështirë ta shpjegoje përse i bënte të qeshnin njerëz it emri i Bog Letinjës. Ndoshta kontrasti me emrat e tjerë, apo vetëm se e kishte ai dhe askush tjetër. Domosdo edhe kundërshtia e atyre tri gërmave fillikate me shtatin e lartë. Emri i tij përfytyrohej në trajtën e gjatovinës si punë shkopi i hollë e i drejtë. E pamundur të imagjinohej një Bog i shkurtër ose i pashëm.

Jo, kjo s'mund të ndodhte.

Kur e pyesnin për origjinën e emrit, krejt ndryshe nga të tjerët, ai mbledhte krahet e menduar me shikim të qashtë prej fëmije dhe një rrudhosje të lehtë në buzën e sipërme.

-Në fillim s'më vunë emër, - thoshte me lezet. - Ngaqë isha ca i shëmtuar, ja shih e shkruaj. Një ditë erdhi dikush, më pa nga afër.

"Hej, Bog!" më përkëdheli, me sa duket i habitur.

Se ç'dreqin deshi të thoshte me ato tri gërma i huaji zor se e mori vesh njeri, po mua ma ngeci emrin dhe që atëhere nuk m'u shqit. Tani më pëlqen! U mësova me të, as e çoj nëpër mend ta ndërroj.

Ndoshta qe e vërtetë ajo që thoshte, po në gojën e tij tingëllonte si punë shakaje e stisur. Në sytë e larguar si të shpendëve, regëtime përherë një buzëqeshje e pafajshme. I dobët, me faqet e futura, pamjen e munduar e patakequr, emetonte humor pa e ditur dhe pa dashur të bënte diçka të tillë.

I biri iu lut në telefon ta kishte kujdes të emër e sëmure. Ushtar në një repart kufitar të largët, qe shumë i lidhur me të dhe i shkonte mendja për keq. Bogu e dëgjoi me vëmendje, pastaj iu përgjigj shumë sinqerisht.

-Patjetër more djallë, unë me të fle. Ata që e dëgjuan sollën ndërmend skenën e vetëkuptuar në shtrat dhe qeshën me paturpësi. Natyrisht Bogu s'kishte asnjë faj. Për të çdo gjë ishte përsosmërisht e zakonshme dhe e thjeshtë.

Kur e zunë në flagrancë Bardhën topolake dhe deshën ta dënonin, Bogu u ngrit pa ngurruar në mes të mbledhjes.

-Pse? - pyeti i habitur, - ajo ka për të gjithë.

Dhe serioziteti i gjyqit popullor u shkërmoq.

Në të vërtetë Bardha nuk ishte aq dosë, sa thoshin. Më vonë e falnderoj Bogun, që kishte në shpirt aq shumë diell, ndërsa ai gjeti rastin ta këshillonte në mënyrë çarmatosëse.

-Një grua nuk bën dot pa ndjenja, prandaj është grua. Veçse kërkohet dashurinë atje ku duhet, - i tha në mënyrë atërore.

Forca e shpotisë së tij nuk shfaqej me vrull; ajo zinte fill natyrshëm dhe shkëlqente gjatë me dritë të butë fosforishente.

Biseda në repartin kufitar qe fare e natyrshme, ndonëse u mbajt mend për shumë kohë. Edhe shakaja në restorant "Driloni". Ai nuk deshi ta vinte në lojë, djaloshti me uniformë e kërkoi vetë me sjelljen e vrazhdë, fare pa takt. Sikur oficeri të kishte respektuar normat më elementare të edukatës, gjithçka do të përfundonte si jo më mirë.

Sidoqë Bog Letinja s'para e vriste mendjen, apo sillej i tillë, të shoqen e këputi malli për djalin. Mbrojtja e atdheut qe punë e vështirë, armiqet bënin plane ta gllarëronin.

Rrallë merrnin letra. Ngutja dhe ëndrrat e gruas e nisën për udhë të largët. Arriti herët kur dita sapo kishte nisur të çirte terrin e natës. Delli i zbehtë e i vakur e priti mysafirin si pjesë natyrale të sinorit që ngrohte.



Tregim nga Istref HAXHILLARI

Shakaja

Mëngjes fundnëntori me mot të paqartë, pllanga drite të kuqërremta mbjellë aty këtu në tokën e kallkanosur. Drita e përgjumur vinte nga lindja përmes një vilari resh tymi e mjegulle, ndërsa nga e majta ujëvara e largët gremisej me oshëtimë teposh-të nëpër majat e shkrepave të afërt. Loja e misterhme e jehonave, rrapëllima e gurëve që përplaseshin, krijonin një zë gati njerëzor i cili fliste e fliste me gjuhë të misterhme.

Dhe ndilte diçka të errët. Plaku ndjeu mornica trishtimi të mezidallueshëm prej boshësisë së lartësive, zërit të fshehur, armiëve afër kufirit. Edhe prej rrugës së largët që e kapiti. Po nuk e humbi toruan. I thanë se i biri kthehej pas dy orësh. U ul drodhi cigare për oficerët që vajtën t'i bënin shoqëri. Përreth u grumbulluan ushtarët kokëqethur të repartit kufitar.

Ata vështronin plot kureshtje mysafirin. Në jetën e vetmuar prej asketësh, ardhësi i largët ishte ngjarje e rrallë. Pastaj aq i çuditshëm! Dukej sikur ca gjurmë shakash gazmore të pathëna i kishin mbetur në cepat e buzëve dhe prisnin rastin të rrëshqisnin prej andej.

-Si ia kaloni? - i pyeti me dashamirësi.

-Fare mirë, - nxituan të përgjigjeshin pothuaj njëzëri. Kishin hequr kapelat dhe kryet e qethura shkëlqenin në diell si grumbull gurësh balltokë.

Po ata? - Bogu bëri me dorë në drejtim të kufirit, një rrip i ngushtë toke e shkriëruar, rrethuar me tela. Kufitarët e quanin brezi i butë.

-Rrinë fshehur, nuk duken nga anët tona, - u përgjigj komandanti i menduar dhe hodhi vështrimin nga shokët.

Ushtarët tundën kokën në shenjë aprovimi. Ato tundje kokash me flokë të shkurtuar deri në rrëzë shprehnin krenari, optimizëm. Sytë rinorë u shkëlqenin.

Dhe Bog Letinja befas u ngarkua emocionalisht.

-Ju lumtë! - i përgëzoi. Në fytyrë i ra një nur madhështor. Disi ceremonial.

Pasoi heshtje e shenjtë, askush s'dinte ç'të thoshte. Për disa minuta nuk u dëgjua veçse klithma e ngjirur e erës. Djemtë me uniformë vështronin të çuditur, secili mbyllur brenda vetes mendimet e fshehta.

Pastaj ushtarë e oficerë, nuk i

dalloje dot të veshur njëloj, qeshën dhe mendoheshin në se rrëfimtari ishteleshko apo mendje e hollë sa mezi kuptohej! Në zërin dhe sjelljen e tij nuk pikasën gjurmë shpotie. Po burri i gjatë e i thatë si shkop, i bënte për të qeshur ashtu kot. Fizionomia e epike dhe tiparet e theksuara të Bog Letinjës i joshnin të vlin buzën në gaz.

Edhe fjalët që nuk u lirin asgjë mangut atyre të eprorëve.

Bogu foli për jetën e begatë në anët e tij, punën e njerëzve, ngazëllimin e paanë. Dëgjuesit e vëmendshëm, padashur e nxisnin me kërshtinë e tyre.

Dhe habiteshin. -Nga bie ky vend i bekuar? - pyeti një ushtar kuqalash shokun në krah. Me sytë naivë nginjur nga çudia dhe admirimi.

-Pusho mor hajvan, - ia ktheu tjetri plot dashamirësi, - askund nuk ka vend të tillë, ai bën shaka!

-Aha! - buzëqeshi i turpëruar kuqalashi.

-Tek ne s'mungon asgjë, - vazhdonte Bog Letinja plot gjallëri. Sytë e kaltër si qiell i ftohtë rrezatonin mirësi.

Ishte në modë të flitej për rolin e gruas apo emancipimin, me të cilin ai qeshte shpesh. Sigurisht nuk mund ta injoronte këtë rrethanë të rëndësishme aktuale.

-Ato bëjnë punë që burrat s'do të mundnin kurrë, - kumtoi serozisht, po nënqeshja e hollë në cepat e buzëve e tradhtoi pak.

Gjeti rastin të shpartallonte aty majë malit ca versione të kundërta të tij, fytyra të ngrysura që nuk i duronte.

-Nuk dinë të qeshin njëherë, a thua bota është kaq e hidhur! - ironizoi.

Ushtarëve u duhej të merrnin paksa me mend personazhe, për të cilët s'kishin kurrfarë ideje. Mirëpo Bogu as që interesohet për të vërtetën e kulluar, megjithëse në ato që tregonte mund të kishte ndonjë thërrime prej saj.

Djalit i tregoi për të emën, vëllezërit e motrat, copëza gazmore nga jeta e tyre. Pastaj e ngriti zërin. -Kështu si po të shoh më bëhet qejfi dhe mallit i thahet koka.

I biri shikoi përçark i dyzuar. Pak krenar, pak i turpëruar. Vetëm për një çast sytë tradhtuan brengën e fshehur me kujdes.

Bogu u largua rreth mesditës. Mbuluar nga shakatë.

Diçka nga qenia gazmore e plakut mbeti në mjedisin e ullinjë të uniformave kufitare. Një mbeturinë shakaje u end përgjatë profileve të repartit, ngulmoi lart nëpër qoshet e rrafshnaltës ngarkuar me dëborë. Djemtë nuk mund ta harronin Bog Letinjën.

Kur zbriti në qytet ishte kohë dreke.

U drejtua nga restorant "Driloni" në qendër. Lokali i mbushur plot gumëzhinte.

-Atje në fund ke një tavolinë të lirë, - e njoftoi kamerieri.

Klientët nxitonin dhe në rrëmujën e përgjithshme pothuaj nuk ra në sy. Ç'është e vërteta ja kishte ënda të këmbente ca fjalë me miq të rastit, ndaj hodhi vështrimin përreth. Sytë e butë soditën ëmbëlsisht të pavaruar prej njëri tjetrit, u rrotulluan një copë herë qosh më qosh të kapnin ndonjë fytyrë të afërt. Po fati e anashkaloi. Në lakun e bebëzave ngjyreqmëshiti nuk ra asnjë i njohur. Mbeti i zhgënjyer.

Dhe u mërzi pakëz.

Derisa në hyrjen e rrëmujshme të restorantit behu oficeri elegant, i krekosur. Pa kapele me pallton hedhur kraheve, qëndroi në këmbë me vështrim nga tavolinat e zëna. Ngutej. Kërkoi me sy hapësirës së lokalit, së fundi u drejtua pa ngurruar në cepin ku kishte zënë vend plaku.

U ul pa kërkuar lehtë.

Dhe pa thënë asnjë fjalë.

Tavolina, deri në atë çast pothuaj bosh, u ngarkua. Dreka e oficerit zuri treçerekun, ndërsa pjata vetmitare e Bogut përfundoi jashtë mbulesës së bardhë, në syprinën me njolla të kafa lagështire dhe mbeturina ushqimesh. Ndonëse "Driloni" ishte restoranti më i mirë i qytetit.

E mbanin për "Turizëm".

I etur të bisedonte me dikë, Bog Letinja nuk u vuri rëndësi rrethanave të pafavorshme, as u mërzi prej tyre. Dinte të çmonte si duhej gjërat e thjeshta të jetës, kurrë nuk ankohet, mirëpo vetminë nuk e duronte.

E shikoi disa herë me shpresë. Oficeri, përhumur në ca mendime të përhitura, nuk e vinte re. Herë, herë i ndriste fytyra nga kushe-di çfarë përjetime të moshës, po fjalët i qenë tharë.

Ose bënte gjoja.

-Ç'kemi! - nuk iu durua Bogut. Qëndrimi i tij i ngrohtë, miqësor.

Oficeri tundi kokën lehtë, sa mezi

u kuptua.

Madje i bezdisur. -Ku shërben? - ngulmoi plaku, tashmë i zhgënjyer, me shpresë të venitur.

Ai nuk u përgjigj, e vështroi pjertras i mërziur sikur donte t'i thoshte: "Na lerë rehat or xhaxho, s'ke punë tjetër?!".

Bog Letinja, i kurrur dhunshëm në cep të tavolinës, u ndje i fyer dhe u revoltua. Djali i pispillosur përballë tij s'ishte veçse qenie e mjerë. Meritonte një mësim sjelljeje.

Pasoi një pauzë e errët derisa vendosi t'i fliste sërish.

Po tani ndryshe.

Më njeh mua? - Zëri u bë më i sigurt e tingëllues me nota tjetërloj, po uniforma përballë nuk mori mundimin ta deshifronte. As kuptoi gjë.

-Jo, - u përgjigj ngadalë me përtesë.

Pak i vonuar si me dy mendje i perëndoi një gjysmëbuzëqeshje të shëmtuar shumë pranë zgërdheshjes.

Më e keqja e sjelljes së paedukatë është se kushdo të dallon lehtë kur fillon të sillesh sadopak i edukuar. Ose gjoja i sjellshëm. Në raste të tilla Bogu ngulte sytë gjatë në një vend, sikur zhbironte hollësisë të padukshme për të tjerët. Ajo ngërdheshje e pështirë u vuri kapakun të gjithave.

Me vështrim mbi pjatë, vendosi t'i shkojë deri në fund lojës, që i vetëtiu në mendje atij çasti.

-Vij nga burgu, - i tha ngadalë, duke gërmëzuar fjalët dhe vazhdoi të hante i patrazuar.

-Bëra njëzet vjet, - plotësoi një çast më vonë.

Gjithaq ngadalë e i sigurt.

"Sikur rrefehej në kishë" i tha më pas oficeri shokut të ngushtë të cilit i hapet pa asnjë rezervë, "as qeshi njëherë djalli!"

Në fillim ai nuk e besoj, harkoi njëren vetull pak me tallje, dyshues. Po dora që mbante pirunin i dridhej pa e kuptuar. E dinte çdo të thoshte ta shihnin me ish të burgosurin. Pati dëgjuar kushedi sa raste.

-Këtu më njohin të gjithë, - shtoi së fundi Bogu me indiferencë.

Për t'u mburrur pakëz.

Dhe për t'i vënë vulën.

Oficeri mbeti i ngurosur. Shqetësimi rritej në mënyrë të njëtrajtshme, merrte përmasa të frikshme. Përfytyroi gjyqin:

"Ç'të lidh me armikun, çfarë biseduat, trego lidhjet?"

Dhe pandehma e tmerrshme e shkatërroi, i ranë pendët, u zgërlaq. Ngriti kokën e shikoi ngultas. Burri me pamje të munduar vazhdonte të përtypte me qetësi.

"Prej burgut, natyrisht" nëpërdhëmbi dhe nuk dyshoi më. "Dreq, nga erdha në këtë tavolinë të mallkuar!"

Ishte goditje e beftë, vetëtimë në verë dhe ashtu si bubullima që pason, pikëllimi kaploi më vonë. Diçka pabesueshmërisht e keqe kacavirrej pas uniformës ushtarake, nuk i shqitë kurrësesi dhe i zinte frymën.

"Mut" tha me vete i tronditur,

"plak i rrezikshëm!"

Duhej larguar prej andej, t'u shpëtonte shikimeve kureshtarë. Ia mbathi me nxitim i trembur për vdekje, pa pikë gjaku në fytyrë.

Kamerieri e ndoqi pas.

-Llogarinë! - i tha dhe e zuri përkrahu, nervoz.

Ai e shikoi i zverdhur me një lloj llahtari. Ndaloj i shpërqëndruar, pagoi menjëherë.

Duke ikur, buzëqeshte kot si budalla.

E shtunë, 26 mars 2011

“Drama shqipe, dashuria ime e parë dhe e vetme”

Flet regjisori veteran Tomi Mato në 85- vjetorin e lindjes

Nga Skënder DEMOLLI

Të gjithë e dimë që teatri është një art sa publik e popullor, aq edhe i thellë e elitar. Por duhet thënë se megjithë progresin teknologjik të informatikës, kur njeriu në këtë fillim shekulli, komunikon në cast me imazhin e bashkëfolësit edhe në fund të botës sikur ta ketë atë parasysh, i vetmi art që mbetet ende i gjallë nëpërmjet kontaktit të drejtë për drejtë fizik me njeriun është teatri.

Dhe teatër pa autor dhe regjisor nuk ka; i pari “shtron shinat, i dyti e ve në lëvizje dhe i jep atij drejtim.” Kjo do të thotë që një nga figurat kryesore të teatrit është regjisori. Madje duhet thënë se megjithëse teatri duket art kolektiv, ky “diktator” i vogël i cili “i tiranizon” aktorët dhe gjithë të tjerët që marrin pjesë në realizimin e shfaqjes, bën që teatri të arrijë qëllimin e vet.

Sot në vendin tonë, ndonëse nga një numur i vogël regjisorësh është krijuar një përvojë e madhe në teatër. Padyshim ata që bënë jo pak, në pak vite dhe duke filluar nga “hiçi”, në një skenë me liri të kufizuar të shprehjes, ishin regjisorët që u përgatitën pas Luftës së Dytë Botërore, në shkollat e artit të vendeve të Evropës Lindore si Mihallaq Luarasi, Selman Vaqari, Kujtim Spahivogli, Pirro Mani, Andrea Malo, Anton Pano, Esat Oktrova, Drita Pelinku, Tomi Mato, Misto Zoto etj.

Disa prej tyre janë personalitete të shquara të teatrit dhe kulturës sonë kombëtare dhe për të arritur deri këtu i paguan “haraç” të rëndë skenës shqiptare. Veçanërisht M. Luarasi e K. Spahivogli që vuajtën burgjeve të diktaturës pseudo – komuniste, por edhe të tjerët që kursesi nuk shpëtuan pa ndëshkime e dënime. Sepse nuk mund të anashkalonin të vërtetën, e cila dalëngadalë kishte filluar të ambalazhohej nga vetë regjimi, me citatet e ideologjisë së kohës. Po për Mihallaq Luarasin teatri ynë kombëtar; “s’ mund të jetë veçse teatër i angazhuar! I angazhuar jo ndaj ndonjë ideologjie, jo ndaj ndonjë partie politike, por i angazhuar ndaj kombit të vet.

Duket se këtë kishte kuptuar edhe Tomi Mato që në bangot e auditorit universitar të Pragës në Çeki, ku edhe u diplomua regjisor teatri në vitin 1957. Sepse në një kohë, kur ende për Evropën plakë Shqipëria s’ ishte gjë tjetër veçse “një shprehje gjeografike”, për here të parë në historinë e vendit tonë, u shfaq një dramë shqipe jashtë kufijve të tij... “Halili dhe Hajrija” në skenën e Studios Teatrale të Akademisë së Arteve të Bukura të Pragës, e cila ka qënë një ndër pjesët më të suksesëshme të Teatrit tonë Kombëtar në ato vite.



Tomi Mato në Mokër

Tomi Mato siç tregon edhe vetë kishte në program si punë diplome të inskenonte “Faustin” e Gëtes, por i nxitur nga ndjenja patriotike, nga dëshira e madhe për të bërë të njohur, në një skenë evropiane dramaturgjine shqiptare dhe historinë e popullit shqiptar me heronjtë e saj, realizoi në gjuhën çeke të përkthyer prej tij dramën e njohur të Kolë Jakovës “Halili dhe Hajrija”.

Shfaqja u dha 15 herë për publikun çek, i cili e priti mjaft mirë dhe shtypi vendas i bëri jehonë dhe u ndal gjerësisht si për dramën ashtu edhe për vënieën e saj në skenë nga regjisori Tomi Mato. Kritika teatrore e kohës u ndal me hollësi në mjaft gazeta, radio e televizion për këtë “Dramë shqiptare në skenën çeke”, apo “Dramë ose tragjedi heroike nga malet e Shqipërisë”. Madje kritikë të teatrit çek, si Eva Knotkova shkrojtën për shfaqjen e kësaj drame edhe në shtypin tonë. Kështu midis të tjerave në një artikull të saj botuar në gazetën “Bashkimi” në qershor të vitit 1957 ajo bënte këtë vlerësim: “Premiera u shfaq në një atmosferë miqësore para publikut. Artistët çekë u përpoqën me vullnet të mirë për t’u afruar shpirtit dhe natyrës shqiptare. Ata punuan dhe ia dolën me sukses. Artistët çekë dhe regjisori sollën këtu një aspekt të luftës së popullit shqiptar për liri... Regjisori Tomi Mato krijoi me dramën “Halili dhe Hajrija” një nga shfaqjet më të mira të sezonit 1956 – ’57 në DISK. Kjo u konstatua edhe nga recensionet e favorshme të shtypit çekoslovak.”

Në këtë mënyrë dy artistë shqiptarë si Tomi Mato e Kolë Jakova, hodhën hapin e parë për paraqitjen e drama-

turgjisë shqiptare në botë dhe bashkëpunimin teatral – ndërkombëtar, bashkëpunim i cili siç e dimë u ndërpre për fat të keq nga izolimi i gjatë që i bëri vendit nga bota ish-regjimi ynë totalitar.

Por ajo që më bën ta ve në dukje tani këtë gjest të harruar patriotik e qytetar të z. Mato, nuk është thjesht mirënjohja e respekti ndaj tij, as për të perkëdhelur krenarinë qytetare, sa gjendja dhe kushtet që na dikton koha, në mjedisin e një konkurrence të forte urbane që zhvillohet kudo sot. Sepse siç dihet në një botë që po ndryshon kaq shpejt, kultura është bërë më e rëndësishme dhe artistët janë një faktor domethënës në politikën kulturore. Vendet më të suksesëshme e shikojnë fokusin kulturor si një element vital të rigjallërimit, qëndrueshmërisë dhe të mbijetesës së tyre. Natyrisht që t’ia arrijmë kësaj, na duhet të kapemi fort pas traditës e trashëgimisë kulturore siç është edhe ky shembull i kahershëm i këtij artisti të skenës shqiptare që përmenda pak më lart, për të cilin Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të qarkut Korçë si dhe Bashkia Pogradec, në një veprimtari të përbashkët, e nderuan regjisorin e parë profesionist të këtij qyteti me çmim të veçantë dhe medaljen e mirënjohjes.

Po ndonëse sot kemi kaq poliglotë e jemi të hapur pa frikë me gjithë botën, të rrallë janë ata që marrin përsipër “të përkthejnë qytetërim” nga qytetërimi ynë.

Prandaj Tomi Mato ashtu si gjithë ajo plejadë regjisorësh që “rritën dhe burrëruan” teatrin tonë, do të vlerësohen jo vetëm për “erën e re” që sollën

në skenën shqiptare, por edhe për punën plot passion e përkushtim, për nxitjen e dramaturgjisë shqiptare dhe trajtimin e saj si element bazë të repertorit të teatrit. Pikërisht me një dramë të tillë e filloi atëherë edhe punën si regjisor në teatrin “A. Z. Çajupi” të Korçës... “Dasmë në luftë” e Minush Jeros, me të cilën ky teatër u nderua me çmim të dytë në Festivalin e Dytë të Teatrove të Dramës në nëntor të vitit 1961. Më pas ngjiti në skenë “Vatra e huaj” të Ndrek Lucës, “Motra Katerinë” të Vangjush Zikos, “Koha gjykon njerëzit” të shkruar prej tij etj. etj. për të cilat është shkruar në shtypin e kohës.

Tani që teatri ynë është në kërkim të vetes, apo realizmit të tij të humbur, po t’ia përmendësh këtë fakt Matos, të thotë se; “rilindja e një teatri ndodh gjithmonë nga produkti vendas. Flet historia e teatrit tonë që në zanafillën e tij... Për mua drama shqipe ishte dhe mbeti dashuria ime e parë dhe e vetme. Teatri ynë duhet të bëjë autokritikë që kohët e fundit i ka kthyer asaj shpinën. Po kështu edhe Ministria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, që sponsorizon lloj e lloj festivalesh, por jo atë që i shërben teatrit dhe dramës shqip.”

Ky shqetësim qytetar nuk e lë të qetë regjisorin veteran e ndonëse këtë 16 prill, hyn në vitin e 85- të të jetës së tij, hip biçikletën e nxiton drejt sallës së teatrit të kukullave, ku “Xinxifiloja” i Pogradecit përgatit premierën e re. Brezi i ri që po rritet është ai që do të veçjë vlerat e reja dhe mënyrat e reja të komunikimit teatror. Dhe regjisori plak Tomi Mato, ka gjithmonë diçka për të thënë... Gëzuar! Edhe 100 vjet të tjera mjeshtëri!

(Vëllimi IV i veprave të Lasgush Poradecit)

Korespondenca e Lasgushit dhe Mitrushit

Më datën 2 prill 2011 në Galerinë e Arteve të qytetit të Pogradecit u promovua përmbledhja e letërkëmbimit midis dy kolosëve të letërsisë shqipe, Lasgush Poradeci dhe Mitrush Kutelit. Letrat janë vendosur në një vëllim të veçantë me titull "Korrespondencë Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli". Ky është vëllimi i katërt i krijimtarisë së poetit Lasgush Poradeci pas atyre të poezive, prozës dhe publicistikës.

Përmbledhja e letrave është përgatitur nga vajzat e poetit Marie dhe Kostandina Gusho. Botimi është i shtëpisë botuese albPAPER Tiranë me sponsorizim privat të zotit Artan Shkëmbi, kryetar i Bashkisë Pogradec.

Letrat e panjohura deri sot, botohen për herë të parë.

Pas prezantimit të librit nga Marie Gusho, folën të pranishmit që mbushnin sallën e Galerisë së Arteve të qytetit. Të afërmit dhe miqtë sollën kujtime nga bashkëbisedimet me poetin, idetë e tij për politikën e kohës.

Në këtë volum shpaloset një botë e mahnitshme e dy njerëzve të kulturuar, me interesa të thella kulturore, letrare, filozofike, fetare, atdhetare etj. Të kulturuar, njohës të disa fushave, gjuhëve dhe koncepteve me moderne të kohës.

Le të hedhim një vështrim kalimthi mbi këtë vëllim.

Në këtë letërkëmbim spikatin inter-



esat e tyre në fushen letrare si embrioni i atij produkti madhështor që ne njohim nga vepra e lënë trashëgim.

Lasgushi shfaqet poet, mendimtaer, filozof etj. Lejtmotivin e jetës së tij, e shpreh që në letrat e para: "Harmonia ime është metafizika ime. Që shpirti të këndojë kërkon elementet e vërteta, kjo është e fshehta e shpirtit tim, harmonia ime, metafizika."

Ose:

"Eruditëria, Mitrush, e ka zemrën e thatë, pamjen e shkurtër, logjikën e ngushtë. Dhimitraq eja të punojmë, të tretemi, të shuhemi për të krijuar në mes të vdekjes një jetë të re, eja të ngre-



him planetin tone".

Dhe më tej:

"Kjo botë ka nevojë për gjëra më me rëndësi sesa topat që gjëmojnë nga urrejtja... Ka nevojë për gjëra më të rënda, subjekte më të larta. Ushqimin qiellor nga i cili merr jetë për jetën."

Pikpamjet filozofike të Lasgushit shpalosen natyrshëm në letrat e tij. Për të është shkruar shumë nga studjuesit dhe unë besoj se tani ata duhet diç të ndreqin në shkrimet e tyre.

Vini re si shkruan Lasgushi:

"Njeriu, shpirti i njeriut s'ndryshon. Je ashtu siç duhet të jesh. Siç pat goditur kur erdhe në këtë botë. Jo më kotë

populli thotë:" ashtu e ka goditur ylli". I huaji nuk mund të japë atë që të përket: veten tënde".

Kurse në një letër të vitit 1931:

"Sa më e zemëruar zemra aq më i madh malli, më i pastër e preciz për t'i rënë pas një besimi gazmor drejt dritës që përshkon gjithësinë. Ajo dritë e përshkon gjithësinë përmes elementeve që janë të pavdekur".

Për frymëzimin që e quan dritë qiellore Lasgushi thotë: "Ti ndjen një dritë universale në shpirtin tënd? Ajo dritë është fuqia jote krijonjëse, fuqi e Zotit krijonjës".

Në anën tjetër të Mitrushi xixëllin ide brilante si subjekt i tregimeve të ardhshme: " Nga çesma e mulla Jaçes, ndanë pllajës së vreshtit janë dy drurë gështenjash. Kur del dielli hija hidhet në të mëngjër, kur hyn më të djathtë. Që atje është një pamje që të çlodh vështrimin."

Ose:

"Pa prituri e pa dituri se qysh u gjenda sot në pragun e pranverës. Dola mb'udhë e pashë botën të ndryshuar. U çudita, s'di as unë përse. Ndofta se pashë qiellin të mbulur me diell."

Janë këto disa pasazhe nga letërkëmbimi i dy figurave të shquara të kulturës pogradecare të shpalosur në këtë vëllim.

Së fundi dëshiroj të theksoj se gati e tërë lënda e rrëfënjave të famshme të Mitrush Kutelit në përmbledhjen "Netë shqipëtare" është qëmtuar në trevat e Mokrës sonë.

Istref HAXHILLARI

Fjalë malli për vendlindjen time

(vijon nga faqja 5)

Une kështu te kam njohur dhe ti vazhdon te ngelesh i tille,mjeshter i fjales dhe per here bindes per degjuesin dhe lexuesin. Behet akoma me interesante pastaj ,kur tek bashkebiseduesi si ti dhe te gazeta ku ti shkruan ,qjen kujtime te perbashketa e idera te njejta.

Ne të dyve na shtohen gjithmone e me shume emozionet, ty per fmijet qe ke ne mergim, mua per vendin tim qe e kam larg. Pyes shpesh veten: eshte malli,apo shenje mizore e plakjes, shkak per emociione te tilla te thella? Jane te dyja e qe te dyja te pa evitueshme, si nje proces fiziologjik. "Rrojtem pa u plakem,"degjoja te thoshte imate,kurse ketu ne Itali degjoj shpesh shprehjen e bukur: "Lum kush arrin te plakem". Prandaj ne te dy,duhet te jemi te lumtur qe po arrijme te plakemi,apo jo? Vetem se pleqeria, ardhka pa kuptuar gje fare e mbi te gjitha, pa ndjere asnje shenje lodhjeje. Me duket sikur dje ,pra vetem nje dite me pare isha njezetvjecar. I dashur Haki,sado qe perpiqem te mos flas per

emigracionin,per hallet e emigrantit,sado qe perpiqem ta shoh goten per here gjysme plot jo gjysme bosh,nuk mund ti shmangem,si shmangem dot,jo se ma ke kerkuar ti jo,por sepse gjuha vete kurdohere atje ku dhemb dhemb. Emigracioni eshte fjala me e lakuar e qe permendet me shpesh se ç'do fjale tjetere sot ne bisedat e perditeshme. Emigracioni sot eshte nje teme e komplikuar dhe e veshtire per ta komentuar, ajo ndoshta kështu ka qene gjithmone,por qe ne nuk e kemi ditur ose dinim vetem aq sa kishim degjuar per te. Kohet kane ndryshuar,por thelbi i tij s'ka ndryshuar. Nje gje ngete e sigurt qe, emigrantet jane kudo njelloj ne bote , pavaresisht nga vijne, nga Evropa, vendat arabe apo Azia. Ata duhet te perballojne mijera veshtiresi,bile ndonjehere te mallkojne fatin(ashtu siç mallkonin dikur italianet e emigruar ne Amerike,Kristofor Kolombin). Sa vete e kane provuar ate para nesh, qe nga gjysherit tane e sa po e provojne sot? Ne bashke kemi folur gjithmone per keto probleme kur takohemi,natyrisht pa pre-

tenduar zgjidhje... e une po vazhdoj monologun tim duke e ditur qe, pasi ta lexosh do te me pergjigjesh ose do te me aprovosh ne heshtje,sepse e di qe te dhemb shpirti, si baba emigrantesh qe je.

Tani po te tregoj, duke e pare goten me te vertete plot e per te cilen e di qe do te gezohesh. Deri pak vite me pare mbanim vendin e pare per kronikat e zeza,jo se na kane harruar,por tani kete vend siç thashe e ka zene komuniteti rumun. Eshte me te vertete kenaqesi e madhe kur lexon ne shtypin e ketushem qe, ne zeme vendin e pare per numurin e studenteve qe ulen ne bangat e shkollave ne Itali,megjithese mbajme vendin e trete per numur popullsie emigrantesh me banim ketu. Llogariten rreth 80 mije studente(jo vetem te shkollave te larta) qe ulen ne bangat e shkollave te ndryshme. Kjo tergon etjen e madhe te te rinjve tane per te studjuar dhe sakrificat e panumurta te familjeve shqiptare per ti derguar neper shkolla femijet e tyre ,megjithë çmimin e larte qe paguajne .

Flitet ketu keq per emigrantet, kur pothuaj gjysma e italianeve punojne e jetojne ne vende te tjera te botes. Ndoshta tere bota s'na ka borxh. Italianet po. Sepse ata, duhet te kujtojne diçka me shume nga te tjeret. Pa u shtyre shume mbrapa ne kohe, mjafton te kujtojme periudhen pas 8 shtatorit 1943. Te mos harrojne ate qe beri populli yne per ushtaret e tyre. Per ata ushtare qe u shperndane neper vendin tone per te shpetuar koken nga egersia gjermane dhe nga uria qe vriste njelloj ne ato kohe. Edhe gjyshi im mbajti dy ushtare per gjashte muaj te fshehur qe si te gjithë te tjeret s'dinin ku te shkonin,me thoshte shpesh babaj. Ti, i dashur miku im, e ke trajtuar aq bukur kete teme ne tregimin "Kur prisnim refugjatet italiane",duke i dhene Mokres ate vlere qe meriton ,prandaj ka pak per te shtuar. Me ka rastisur te takoj shume nga ata pjesemarres te luftes ne Shqiperi dhe si per ironi te fatit edhe nje protagonist te betejes se Pojskes,te cilit per çudi si kish ngelur ne kujtese gjaku i derdhur aty,por fakti qe ne ate

zone gjenin shume breshka per ti ngrene e shuar urine. Siç duket uria ia kish errur aq shume syte dhe mendjen,sa qe edhe pas pesedhete e ca vitesh nuk i ishin kthjelluar akoma. Ai permendete vetem fjalet "lago di ohrida," Gorizia" dhe "tartarughe",por ma thote mendja qe ishte nje harrese, ndoshta e moshes e jo dashakeqesi. Megjithate duhet thene se ai dhe te tjere pjesemarres ne luften kunder Shqiperise, u treguan dashamires e mu gjenden prane ,sidomos ne ditet e para,duke mu drejtuar mua dhe femijeve me ato pak fjale shqip qe ju kishin ngelur ne mendje akoma si: "Mirdita", "mirmbrema ", "shum mir", "dreç","buk", "uj" ose "Papa shum mir."etj.

Të nderuar zotërinj të gazetës "Mokra"! Për çka shkruajta konsiderojeni një bisedë të rëndësishme ku në mes nesh kemi mikun që i ka bërë vend vetes të jetë i denjë për ju. Njëhëwërsh ju falënderoj për botimin e shkrimit tim si homazh për Qemal Bufin.

Gëzuar dhe urime për 12-vjetorin e gazetës "Mokra"!

Fahri BUFI